



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pradati Received/Delivety	06.11.2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	Ur Prot Ur Prot Prot No	Shtypja Pajtoj Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SHKIPSHOK	6880/2023		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.Nr.1193/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1193/2023, të datës 22.09.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga Malisheva, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike „masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.11.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1193/2023, të datës 22.09.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil \_\_\_\_\_ (këtu e tutje vetëm ankuesi), me datë 22.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1193/2023, kundër Vendimit me numër te protokollit 2186/2023 të datës 08.09.2023 të Komisionit Disiplinor në Inspektoratin e Punës, për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të procedurës dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm *Këshilli*) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Inspektorati i Punës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 26.09.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 6187/2023 të datës 22.09.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.09.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.09.2023 nga Inspektorati i Punës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Konkursin me numër të referencës RN00011780 të datës 05.06.2023; Komunikimin elektronik të datës 29.08.2023 ndërmjet zyrtarëve gjegjësisht të Inspektoratit të Punës dhe ankuesit; Vendimin me Nr.Prot.2186 të datës 08.09.2023 të Komisionit Disiplinor në Inspektoratin e Punës; Vërtetimin me Nr.Prot:1531 të datës 20.06.2023 të datës 20.06.2023 nga Menaxheri i Personelit-ankuesi; Vendimin me numër A.nr.851/2023 të datës 31.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.657/2023 të datës 22.08.2023 nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinatorit si dhe Komunikimin elektronik të datës 06.09.2023 dhe 06.05.2023 ndërmjet ankuesit dhe zyrtarit N.A si dhe Vendimin me numër A.nr.1228/2023 të datës 01.11.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1193/2023 të datës 22.09.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se me kërkesë të kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës të datës 29.08.2023, Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit. Ky i fundit me Vendimin me numër të protokollit Nr.2186/2023 të datës 08.09.2023, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore “*Pezullim nga detyra deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor i IP-së*”, e të cilin vendim ankuesi e ka kundërshtuar përmes ankesës A.nr.1193/2023 të datës 22.09.2023, mbi bazën: Vlerësim i gabuar i gjendjes faktike, shkelje esenciale të procedurës dhe aplikim i gabuar i ligjit material.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë se ankuesi me datë 02.10.2023, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke atakuar Vendimin përfundimtar me Nr.2322 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 02.10.2023, me Vendimin A.nr.1228/2023, të datës 01.11.2023 ka vendosur edhe për çështjen e cila ka qenë objekt shqyrtimi sipas ankesës me numër A.nr.1193 të datës 22.09.2023, rrejdhimisht Këshilli ka anuluar Vendimin me numër të protokollit 2322 të datës 26.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, duke obliguar Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të kthejë ankuesin në pozitën e punës sipas Aktit të Emërimit me numër të protokollit 02/2021 të datës 19.04.2021, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bëjë kompensimin e pagave të porealizuara nga data 08.09.2023 të ndaluara sipas Vendimit me numër të protokollit 2186 të Komisionit Disiplinor. Andaj, mbi këtë bazë, e në kuptim të dispozitave të nenit 101, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për



Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilat është përcaktuar se: “Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë..”, Kolegji vlerësoj që janë përmbushur kërkesat ligjore për përfundim të procedurës administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1193/2023 të datës 22.09.2023 të parashtruar nga ankuesi Florim Krasniqi.

Përmbledhur si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1193/2023.*

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj-Demi**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit .
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

